

Komuna e Rahovecit

Kabineti i Kryetarit

LISTA E VENDIMEVE TË MARRA NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT, Z. SMAJL LATIFI

MUAJI DHJETOR 2025

Nr	Emri i vendimit	Nr. Protokollit
1.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e autoambulancës.	NRP-02-6727-2025
2.	Vendim për përfundimin e pezullimit të mardhënies së punës.	NRP-02-6730-2025
3.	Vendim për përfundimin e Marrdhënies së Punës.	NRP-02-6731-2025
4.	Vendim për qasje në dokumente publike.	NRP-02-6733-2025
5.	Vendim për lirimin nga pozita e drejtoreshës së Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.	NRP-02-6736-2025
6.	Vendim për lirimin nga pozita e drejtorit të Drejtorisë për Administratë.	NRP-02-6737-2025
7.	Vendim për lirimin nga pozita e drejtorit të Drejtorisë për Bujqësi-Pylltari dhe Zhvillim Rural.	NRP-02-6738-2025
8.	Vendim për lirimin nga pozita e nënkryetarit të Komunës së Rahovecit.	NRP-02-6739-2025
9.	Vendim për lirimin nga pozita e drejtoreshës së Drejtorisë për Inspektim.	NRP-02-6740-2025
10.	Vendim për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).	NRP-02-6741-2025
11.	Vendim për përfshirjen në listën e pagës me pagë të plotë mujore.	NRP-02-6742-2025
12.	Vendim për qasje në dokumente publike.	NRP-02-6743-2025
13.	Vendim për caktimin e jurisë profesionale për dhënien e cmimit letrar-Sulejman Krasniqi.	NRP-02-6749-2025
14.	Vendim për emërimin e personave zyrtar, autorizues, zotues, certifikues, pranimeve për administratë, shëndetësi dhe arsim për vitin 2026.	NRP-02-6753-2025
15.	Vendim për vendimin për pezullimin e përkohshëm të mardhënies së punës.	NRP-02-6754-2025
16.	Vendim për vendimin për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës "Sigurimi I automjetve të Komunës së Rahovecit".	NRP-02-6755-2025
17.	Vendim për vendimin për pezullimin e përkohshëm të mardhënies së punës.	NRP-02-6756-2025
18.	Vendim për vendimin për pezullimin e përkohshëm të mardhënies së punës.	NRP-02-6757-2025

19.	Vendim për për kolaodimin e pozicioneve në kontratën me titull: "Ndërtimi dhe rregullimi i infrastrukturës në stacionin e autobusave-Ritenderim"	NRP-02-6765-2025
20.	Vendim për vendimin për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve.	NRP-02-6767-2025
21.	Vendim për caktimin e grupit punues për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve investive të Komunës së Rahovecit.	NRP-02-6769-2025
22.	Vendim për emërimin e Zyrtares për Marrdhënie me Publikun në Kabinetin e Kryetarit të Komunës.	NRP-02-6780-2025
23.	Vendim për emërimin e Zyrtarit Administrativ në Kabinetin e Kryetarit të Komunës.	NRP-02-6781-2025
24.	Vendim për emërimin e Shefit të Kabinetit në Zyrën e Kryetarit të Komunës.	NRP-02-6782-2025
25.	Vendim për emërimin e Zyrtarit për Logjistikë në Kabinetin e e Kryetarit të Komunës.	NRP-02-6783-2025
26.	Vendim për ndërprerjen e kontratës së dyanëshme "Furnizimmi me pelet për nevojat e Komunës së Rahovecit"	NRP-02-6791-2025
27.	Vendim për për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve.	NRP-02-6794-2025
28.	Vendim për përfundimin e pezullimit të mardhënies së punës.	NRP-02-6795-2025
29.	Vendim për miratimin e kërkesës për vazhdimin e mbështetjes nga Masat Emergjente të Riatdhesimit për akomodim.	NRP-02-6796-2025
30.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e dëmeve materiale dhe financiare në QMF Familjare në Ratkoc.	NRP-02-6797-2025
31.	Vendim për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve.	NRP-02-6798-2025
32.	Vendim për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve.	NRP-02-6806-2025
33.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave	NRP-02-6814-2025
34.	Vendim për miratimin e kërkesës -Mbulimi i shpenzimeve te lehonisë-Lindjes.	NRP-02-6818-2025
35.	Vendim për miratimin e kërkesës -Mbulimi i shpenzimeve te lehonisë-Lindjes.	NRP-02-6819-2025
36.	Vendim për caktimin e menaxherit dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejt-Pastrimi dhe mirëmbajtja higjienike e objekteve të komunës.	NRP-02-6820-2025
37.	Vendim për caktimin e menaxherit dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejt-Pastrimi dhe mirëmbajtja higjienike e objekteve të komunës.	NRP-02-6821-2025
38.	Vendim për pezullimin e marrdhënies së punës.	NRP-02-6824-2025
39.	Vendim për pezullimin e marrdhënies së punës.	NRP-02-6825-2025



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 6727 Nr. i faq./Br.str./No.pg 175
Data/Datam/Date 01 / 12 / 25
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008") dhe nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e autoambulancës

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e autoambulancës, që është dhuruar donacion nga Ministria e Shëndetësisë, për nevojat e QKMF-së në Rahovec, në këtë përbërje:
 - 1.1. Samir Hasku, kryesues,
 - 1.2. Luan Sharku, anëtar,
 - 1.3. Bekim Krasniqi, anëtar.
2. Komisioni ka për detyrë që të konstatojë dhe të bëjë vlerësimin e autoambulancës, që është dhuruar nga Ministria e Shëndetësisë, për nevojat e QKMF-së në Rahovec.
3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë deri më datë 5.12.2025.
5. Pas përfundimit të punëve, komisioni do të hartojë raport me shkrim për kryetarin e Komunës dhe për Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Anëtarët e komisionit,
- Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI / KRJETARIT TË KOMUNËS / KABINET / PRESIDENTI I OPŠTINËS / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 6730 Nr. i faq./Br.str./No.pg 175
Data/Datum/Date 01 / 12 / 25
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 71 paragrafi 1 lidhur me nenin 86 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-294, nenit 41 paragrafi 2 i Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 90/2010”), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.3.2017, kërkesës së Avni Morina nga fsh. Vrajak me nr. prot. 3922 të datës 01.12.2025, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për përfundimin e pezullimit të marrëdhënies së punës

1. **Miratohet** si e bazuar kërkesa e Avni Morinës nga fshati Vrajak, komuna e Rahovecit, me nr. prot. 3922, e datës 1.12.2025, për përfundimin e pezullimit të marrëdhënies së punës.
2. I lartpërmenduri kthehet në pozitën e njëjtë të marrëdhënies së punës mësimdhënës i lëndës së fizikës në ShML “12 Maji” në Ratkoc nga data 1.12.2025.
3. Obligohet zyrtari/ja për paga në Drejtorinë për Arsim dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa ta fusin në listën e pagave të lartpërmendurin sipas pikës 1 të këtij vendimi
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Arsim dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me nr. prot. 21/18, i datës 12.1.2018.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Avni Morina, i sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: mësimdhënës i lëndës së fizikës në ShML “12 Maji” në Ratkoc, më datë 12.1.2018, ka bërë kërkesë për pezullimin e marrëdhënies së punës për shkak të emërimit në pozitën e drejtorit të Drejtorisë për Arsim në Komunën e Rahovecit.

Pas përfundimit të mandatit të drejtorit të drejtorisë, Avni Morina ka bërë kërkesë me nr. prot. 3922, të datës 1.12.2025, për përfundimin e pezullimit të marrëdhënies së punës dhe njëkohësisht kthimin e tij në vendin e mëparshëm të punës si mësimdhënës i lëndës së fizikës në ShML “12 Maji” në Ratkoc.

Andaj, pas shqyrtimit të të gjitha provave, duke u bazuar në nenin 41, paragrafi 2 i Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 dhe nenin 71, paragrafi 1 lidhur me nenin 86 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-294, z. Avni Morina nga fshati Ratkoc, i përfundon pezullimi i marrëdhënies së punës për shkak të emërimit në pozitën e drejtorit të Drejtorisë për Arsim



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6731 Nr. i faq./Br.str./No.pg 176

Data/Datum/Date 02 / 12 / 25

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 75, paragrafi 1 i Ligjit për Zyrtarët Publikë, Nr.08/L-197, si dhe nenit 92 të Statutit të komunës së Rahovecit, kryetari i Komunës, merr:

VENDIM
PËR PËRFUNDIMIN E MARRËDHËNIES SË PUNËS

1. Znj. Qëndresë Kryeziu-Hoxha nga fshati Xërxë, me banim në Rahovec, në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe e sistemuar në punët dhe në detyrat e punës: Zyrtar për Buxhet dhe Financa, në Drejtorisë për Buxhet, **I PËRFUNDON marrëdhënia e punës në shërbimin civil** nga data 28.11.2025.

2. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m
Financa

Qëndresë Kryeziu-Hoxha nga fshati Xërxë, me banim në Rahovec, në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe e sistemuar në punët dhe në detyrat e punës: Zyrtar për Buxhet dhe Financa, në Drejtorinë për Buxhet, përmes kërkesës për dorëheqje, është drejtuar Njesisë së Personelit, dhe drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, z. Afrim Limani, me kërkesë për dorëheqje, më datë 1.12.2025, se ajo ka dhënë dorëheqje nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil, për arsye familjare.

Sipas nenit 75, paragrafi 1 i Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.08/L-197, marrëdhënia e punës në shërbimin civil përfundon kur nëpunësi civil jep dorëheqje nga detyra.

Prandaj, kryetari i Komunës, pas administrimit të provave dhe të fakteve mbi gjendjen reale, vendos si në dispozitiv të vendimit.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi, pala ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të vendimit, Komisionit komunal për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesa.

Me vendim të njoftohen:

1. Qëndresë Kryeziu-Hoxha,
2. Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
3. Dosja personale, dhe
4. Arkivi.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 21 dhe 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 11 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për qasje në dokumente publike

1. **Miratohet** e bazuar kërkesa me nr. prot.6721, e datës 24.11.2025, për qasje në dokumente publike nga Kimete Hoti dhe i ofrohet qasje e **plotë** në dokumente publike, dhe atë në: Procesverbalin e datës 19.11.2025, të hartuar nga inspektorët e Komunës gjatë inspektimit në rr. “Safet Latifi” në Ratkoc, kërkesën e paraqitur nga z. Ahmet Xhem Hoti, drejtuar Komunës së Rahovecit, lidhur me mbylljen e pusetës në këtë rrugë, si dhe nënshkrimet e banorëve të tjerë, që sipas tij kanë qenë të koordinuar për këtë qëllim.
2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Në mbështetje të nenit 10, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (QDP), Komuna e Rahovecit, ka pranuar kërkesën me nr. prot. 6721, e datës 24.11.2025, nga Kimete Hoti, për qasje në dokumente publike.

Pas shqyrtimit të kërkesës, ofrohet qasje e **plotë** në dokumente publike dhe atë në: Procesverbalin e datës 19.11.2025, të hartuar nga inspektorët e Komunës gjatë inspektimit në rr. “Safet Latifi” në Ratkoc, kërkesën e paraqitur nga z. Ahmet Xhem Hoti, drejtuar Komunës, lidhur me mbylljen e pusetës në këtë rrugë, si dhe nënshkrimet e banorëve të tjerë, që sipas tij kanë qenë të koordinuar për këtë qëllim.

Kërkesa për qasje në dokumente publike është pranuar në mënyrë elektronike.

Komuna e Rahovecit, pas shqyrtimit të kërkesës, si dhe pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në Agjencinë për Informim dhe Privatësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e pranimit të tij.

Vendimi u dërgohet:

- **Blerta Gashit**, zyrtare për shqyrtimin fillestar të QDP-së,
- **Kimete Hotit**, dhe
- **Arkivit**.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 6736 Nr. i faq./Br.str/No.pg 176
Data/Datum/Date 04 / 12 / 25
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13, nenit 58 shkronja f) dhe nenit 62 paragrafi 2 të Ligjit Nr-03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr-28/2008") dhe nenit 81 paragrafi 1.1 dhe nenit 84 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për lirim nga pozita e drejtoreshës së Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale

1. Znjsh. Saranda Sallteku **LIROHET** nga pozita e drejtoreshës së Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Komunën e Rahovecit nga data 05.12.2025.
2. Autorizohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të lartpërmendurën në pikën 1 të këtij vendimi ta largoj nga lista e pagës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Njësia e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
4. Ky vendim hyn në fuqi me datë 05.12.2025.

Me vendim të njoftohen:

- Saranda Sallteku,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- NJMBNJ, dhe
- Arkivi.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6737 Nr. i faq./Br.str./No.pg 176

Data/Datum/Date 04 / 12 / 25

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13, nenit 58 shkronja f) dhe nenit 62 paragrafi 2 të Ligjit Nr-03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr-28/2008") dhe nenit 81 paragrafi 1.1 dhe nenit 84 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për lirim nga pozita e drejtorit të Drejtorisë për Administratë

1. Z. Besnik Hoti **LIROHET** nga pozita e drejtorit të Drejtorisë për Administratë në Komunën e Rahovecit nga data 05.12.2025.
2. Autorizohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të lartpërmendurin në pikën 1 të këtij vendimi ta largoj nga lista e pagës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Njësia e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
4. Ky vendim hyn në fuqi me datë 05.12.2025.

Me vendim të njoftohen:

- Besnik Hoti,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- NJMBNJ, dhe
- Arkivi.

Smail Latifi

Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESIDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 6738 Nr. i faq./Br.str./No.pg 176
Data/Datum/Date 04 / 12 / 25
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13, nenit 58 shkronja f) dhe nenit 62 paragrafi 2 të Ligjit Nr-03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr-28/2008") dhe nenit 81 paragrafi 1.1 dhe nenit 84 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për lirim nga pozita e drejtorit të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

1. Z. Berat Duraku **LIROHET** nga pozita e drejtorit të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Komunën e Rahovecit nga data 05.12.2025.
2. Autorizohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të lartpërmendurin në pikën 1 të këtij vendimi ta largoj nga lista e pagës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Njësia e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
4. Ky vendim hyn në fuqi me datë 05.12.2025.

Me vendim të njoftohen:

- Berat Duraku,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- NJMBNJ, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESEDNIJA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 6739 Nr. i faq./Br.str/No.pg 176
Data/Datum/Date 04 / 12 / 25
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13, nenit 58 shkronja f) dhe nenit 60 paragrafi 60.2 të Ligjit Nr-03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr-28/2008") dhe nenit 79 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për lirim nga pozita e nënkryetarit të Komunës së Rahovecit

1. Z. Fatmir Iska **LIROHET** nga pozita e nënkryetarit të Komunës së Rahovecit nga data 05.12.2025.
2. Autorizohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të lartpërmendurin në pikën 1 të këtij vendimi ta largoj nga lista e pagës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Njësia e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
4. Ky vendim hyn në fuqi me datë 05.12.2025.

Me vendim të njoftohen:

- Fatmir Iska,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- NJMBNJ, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR GABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 6740 Nr. i faq./Br.str./No.pg 176
Data/Datum/Date 04 / 12 / 25
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13, nenit 58 shkronja f) dhe nenit 62 paragrafi 2 të Ligjit Nr-03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr-28/2008") dhe nenit 81 paragrafi 1.1 dhe nenit 84 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për lirim nga pozita e drejtoreshës së Drejtorisë për Inspektim

1. Znjsh. Nora Boshnjaku **LIROHET** nga pozita e drejtoreshës së Drejtorisë për Inspektim në Komunën e Rahovecit nga data 05.12.2025.
2. Autorizohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të lartpërmendurën në pikën 1 të këtij vendimi ta largoj nga lista e pagës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Njësia e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
4. Ky vendim hyn në fuqi me datë 05.12.2025.

Me vendim të njoftohen:

- *Nora Boshnjaku,*
- *Drejtoria për Buxhet dhe Financa,*
- *NJMBNJ, dhe*
- *Arkivi.*





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Nr./Br./No 6741 Nr. i faq./Br.str./No.pg 177
Data/Datumi/Date 04/12/25
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.4 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e [redacted] nga Rahoveci me Nr. Protokolit 06-553/01-0045240/25, e dt. 04.12.2025 për ndihmë financiare prej 500.00€ (pesëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Zn [redacted] nga Rahoveci me datë 04.12.2025 ka parashtruar kërkesë për ndihmë financiare për lehonitë (lindje) pasi që me datë 26.11.2025 ka lindur **Vajzë** në QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec.

Marrë parasysh se, e lartpërmendura nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe me këtë rast e njëjta pas shpenzimeve të lindjes e ka të vështirë përballimin e shpenzimeve të blerjes së gjërave elementare për fëmijën, është e domosdoshme ndihma financiare për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë për [redacted] si dhe ndihma për sigurimin e gjërave elementare për foshnjën.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Me vendim të njoftohen:

- Znj. [redacted] nga Rahoveci,
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.

Smajl Latifi
Kryetari i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality of Orahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine/Municipal Mayor

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6742 Nr. i faq./Br.str/No.pg 177

Data/Datum/Date 04 / 12 / 25

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, si dhe nenit 92 të Statutit të komunës, Kryetari i komunës merr këtë :

V E N D I M

1. **OBLIGOHET** Drejtoria për Buxhet dhe Financa që znj. Kosovare Gashi, e sistemuar në detyrat e punës si Zyrtare për Blegtori, Bletari dhe Veterinari pranë Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Komunën e Rahovecit, të përfshihet në listat e pagave me pagë të plotë mujore, duke filluar nga data 23.11.2025.

2. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimit iu dorëzohet:

1. Kosovare Gashi
2. Drejtorisë për Financa dhe Buxhet
3. Njësia e Përsoneelit
4. Arkiva.

Kryetari i komunës

Smajl Latifi





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine

Municipal Mayor



Njesia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6743 Nr. i faq./Br.str/No.pg 177

Data/Datum/Date 04 / 12 / 25

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 21 dhe 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 11 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për qasje në dokumente publike

1. **Miratohet** e bazuar kërkesa me nr. prot.6717 e datës 20.11.2025, për qasje në dokumente publike nga Fondacioni për të drejtat e kafshëve dhe i ofrohet qasje e **plotë** në dokumente publike, dhe atë në: Kontratën me numër: 623-23-1687-2-2-1-C/470, me titull "TRAJTIMI I QENVE ENDACAK NE KOMUNËN E RAHOVECIT." të dhënë nga Komuna e Rahovecit.
2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Në mbështetje të nenit 10, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (QDP), Komuna e Rahovecit, ka pranuar kërkesën me nr protokolli 6717 e datës 20.11.2025, nga Fondacioni për të drejtat e kafshëve, për qasje në dokumente publike.

Pas shqyrtimit të kërkesës, ofrohet qasje e **plotë** në dokumente publike dhe atë në: Kontratën me numër: 623-23-1687-2-2-1-C/470, me titull "TRAJTIMI I QENVE ENDACAK NË KOMUNËN E RAHOVECIT." të dhënë nga Komuna e Rahovecit.

Kërkesa për qasje në dokumente publike është pranuar në mënyrë elektronike.

Komuna e Rahovecit, pas shqyrtimit të kërkesës, si dhe pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në Agjencinë për Informim dhe Privatësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e pranimi të tij.

Vendimi u dërgohet:

- **Blerta Gashit**, zyrtare për shqyrtimin fillestar të QDP-së,
- **Fondacionit** për të drejtat e kafshëve, dhe
- **Arkivit**.

Smajl Latifi

Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna Rahovec
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Mayor Office



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET	
Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)	
Nr./Br./No 6749	Nr. i faq./Br.str./No.pg 177
Data/Datum/Date 05 / 12 / 25	
RAHOVEC / ORAHOVAC	

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017 dhe Konkursit për krijimtari letrare (për të rritur) të shpallur nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport Nr. 13/2025 të dt. 7.11.2025, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e jurisë profesionale për përzgjedhjen e krijimtarisë më të mirë letrare për dhënien e çmimit letrar "Sulejman Krasniqi"

1. Caktohet juria profesionale për përzgjedhjen e krijimtarisë më të mirë letrare - artistike për dhënien e çmimit letrar "Sulejman Krasniqi", në këtë përbërje:
 - 1.1. Xhevat Sylja, kryesues,
 - 1.2. Phd. c. Leonita Parallangaj, anëtare,
 - 1.3. Dr. sc. Shefqet Dinaj, anëtar.
2. Juria profesionale ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin e të gjitha krijimtarive letrare – artistike, përzgjedhjen e krijimtarisë më të mirë letrare dhe propozimin për krijimtarinë më të mirë letrare për dhënien e çmimit letrar "Sulejman Krasniqi".
3. Obligohet juria profesionale që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në konkursin për krijimtari letrare Nr. 13/2025, të datës 7.11.2025, të shpallur nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
4. Juria profesionale do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen anëtarët e jurisë dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
6. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të jurisë,
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe
- Arkivit.


Smajl Latifi
Kryetari i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 6753, Nr. i faq./Br.str/No.pg 178
Data/Datum/Date 10 / 12 / 25
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008") dhe nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e personave zyrtar, autorizues, zotues, certifikues, pranimeve për administratë, shëndetësi dhe arsim për vitin 2026

1. Me këtë vendim **emërohen** personat zyrtar, autorizues, zotues, certifikues, pranimeve për administratë, shëndetësi dhe arsim për vitin 2026, në këtë përbërje:

1.1 Zyrtar/e Autorizues/se për listën e pagave:

- Afrim Limani - kryesor

1.2 Zyrtar/e Autorizues për paga në Shëndetësi:

- Elbunit Kryeziu – kryesor

1.3 Zyrtar/e Autorizues për paga në Arsim:

- Afrim Limani – kryesor

1.4 Zyrtar/e Autorizues i Shpenzimeve:

- Perparim Krasniqi – kryesor

1.5 Zyrtar/e Autorizues i Shpenzimeve për Shëndetësi:

- Elbunit Kryeziu – kryesor

1.6 Zyrtar/e Autorizues i Shpenzimeve për Arsim:

- Afrim Limani – kryesor
- Jeton Krasniqi – zëvendës

1.7 Zyrtar/e Autorizues për urdhërblerja - proces order:


- Astrit Mullabazi – kryesor
- Enise Dina - zëvendës

1.8 Zyrtar/e Zotues:

- Mimoza Ejupi - kryesor
- Ardian Rama – zëvendës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 25, nenit 68 paragrafi 1, nenit 69 paragrafi 1 nënparagrafi 1.8 lidhur me nenin 86 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 13 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 i Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për pezullimin e përkohshëm të marrëdhënies së punës

1. **Z. Ali Dula**, i sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Mësimdhënës në SHML "Xhelal Hajda - Toni" në Rahovec, i pezullohet përkohësisht marrëdhënia e punës, pa pagesë, për shkak të kandidimit për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në zgjedhjet e parakohshme të cilët do të mbahet me datë 28 dhjetor 2025.
2. Pezullimi i përkohshëm i marrëdhënies së punës sipas pikës 1 të këtij vendimi, fillon 7 (shtatë) ditë para periudhës së hapjes zyrtare të fushatës dhe përfundon 5 (pesë) ditë pas mbylljes zyrtare të fushatës, konkretisht nga data 10 dhjetor 2025 deri më datë 2 janar 2026.
3. I lartpërmenduri e ruan të drejtën e kthimit në pozitën e mëparshme pas përfundimit të pezullimit të cekur në pikën 2 të këtij vendimi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Arsim, SHML "Xhelal Hajda - Toni" në Rahovec dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Z. Ali Dula, i sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Mësimdhënës në SHML "Xhelal Hajda - Toni" në Rahovec, është kandidat për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në zgjedhjet e parakohshme të cilët do të mbahet me datë 28 dhjetor 2025.

Në nenin 25 paragrafi 5 i Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, është e përcaktuar që zyrtarët publikë të cilët kandidojnë për zgjedhjet qendrore ose lokale, duhet të pezullojnë vendin e punës 7 (shtatë) ditë para periudhës së hapjes zyrtare të fushatës dhe përfundon 5 (pesë) ditë pas mbylljes zyrtare të fushatës.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6755 Nr. i faq./Br.str/No.pg 178

Data/Datum/Date 10 / 12 / 25

RAHOVEC/ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe propozimit të Përgjegjësit të Njesisë Kërkuese dhe Zyrtares Përgjegjëse të Prokurimit, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: **"Sigurimi i automjeteve të Komunës së Rahovecit"**, me numër të kontratës: **623-25-9589-2-2-1/C702**, si në vijim:
 - 1.1. Samir Hasku, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Përgjegjës për automjetet zyrtare, në Drejtorinë për Administratë, **CAKTOHET** menaxhere e Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2. Ruzhdi Krasniqi, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtar i lartë për Siguri, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës, si dhe të rregullave të tjera, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe të emërimit të Menaxherit të kontratës (MK), të gjitha përgjegjësitë, përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë Kontratën, barten nga zyra e prokurimit të Menaxherit të Kontratës.
3. Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës janë:
 - 3.1. Menaxheri i kontratës do të menaxhojë obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në kontratë;
 - 3.2. Menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë; dhe
 - 3.3. Menaxheri i kontratës do të bëjë vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.
4. Funksionet e Menaxherit të Projektit/Kontratës, janë:
 - 4.1. Në pajtim me Kapitullin V të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës, duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të fillojë me fazat e menaxhimit të Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, Menaxheri i kontratës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 25, nenit 68 paragrafi 1, nenit 69 paragrafi 1 nënparagrafi 1.8 lidhur me nenin 86 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 13 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 i Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për pezullimin e përkohshëm të marrëdhënies së punës

1. **Znj. Tringa Morina**, e sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Edukatore në Çerdhen e Fëmijëve "Tulipanët" në Rahovec - paralelja e ndarë në Krushë e Madhe, i pezullohet përkohësisht marrëdhënia e punës, pa pagesë, për shkak të kandidimit për deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në zgjedhjet e parakohshme të cilët do të mbahet me datë 28 dhjetor 2025.
2. Pezullimi i përkohshëm i marrëdhënies së punës sipas pikës 1 të këtij vendimi, fillon 7 (shtatë) ditë para periudhës së hapjes zyrtare të fushatës dhe përfundon 5 (pesë) ditë pas mbylljes zyrtare të fushatës, konkretisht nga data 10 dhjetor 2025 deri më datë 2 janar 2026.
3. E lartpërmendura e ruan të drejtën e kthimit në pozitën e mëparshme pas përfundimit të pezullimit të cekur në pikën 2 të këtij vendimi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Arsim, Çerdhja e Fëmijëve "Tulipanët" në Rahovec dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Arsyetim

Znj. Tringa Morina, e sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Edukatore në Çerdhen e Fëmijëve "Tulipanët" në Rahovec - paralelja e ndarë në Krushë e Madhe, është kandidatë për deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në zgjedhjet e parakohshme të cilët do të mbahet me datë 28 dhjetor 2025.

Në nenin 25 paragrafi 5 i Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, është e përcaktuar që zyrtarët publikë të cilët kandidojnë për zgjedhjet qendrore ose lokale, duhet të pezullojnë vendin e punës 7



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



	REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET		
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)		
Nr./Br./No <u>6757</u> Nr. i faq./Br.str./No.pg <u>178</u>		
Data/Datum/Date <u>10/12/25</u>		
RAHOVEC/ORAHOVAC		

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 25, nenit 68 paragrafi 1, nenit 69 paragrafi 1 nënparagrafi 1.8 lidhur me nenin 86 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 13 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 i Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për pezullimin e përkohshëm të marrëdhënies së punës

1. **Z. Dreni Kastrati**, i sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Mjek në QKMF “Dr. Fahredin Hoti” në Rahovec, i pezullohet përkohësisht marrëdhënia e punës, pa pagesë, për shkak të kandidimit për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në zgjedhjet e parakohshme të cilët do të mbahet me datë 28 dhjetor 2025.
2. Pezullimi i përkohshëm i marrëdhënies së punës sipas pikës 1 të këtij vendimi, fillon 7 (shtatë) ditë para periudhës së hapjes zyrtare të fushatës dhe përfundon 5 (pesë) ditë pas mbylljes zyrtare të fushatës, konkretisht nga data 10 dhjetor 2025 deri më datë 2 janar 2026.
3. I lartpërmenduri e ruan të drejtën e kthimit në pozitën e mëparshme pas përfundimit të pezullimit të cekur në pikën 2 të këtij vendimi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, QKMF “Dr. Fahredin Hoti” në Rahovec dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Z. Dreni Kastrati, i sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Mjek në QKMF “Dr. Fahredin Hoti” në Rahovec, është kandidat për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në zgjedhjet e parakohshme të cilët do të mbahet me datë 28 dhjetor 2025.

Në nenin 25 paragrafi 5 i Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, është e përcaktuar që zyrtarët publikë të cilët kandidojnë për zgjedhjet qendrore ose lokale, duhet të pezullojnë vendin e punës 7 (shtatë) ditë para periudhës së hapjes zyrtare të fushatës dhe përfundon 5 (pesë) ditë pas mbylljes zyrtare të fushatës.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No <u>6765</u> Nr. i faq./Br.str./No.pg <u>179</u>
Data/Datum: Date <u>10 / 12 / 25</u>
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Ligjit 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18/2011"), dispozitave të Rregullores Nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kontratës me titull "Ndërtimi dhe rregullimi i infrastrukturës në stacionin e autobusëve - Ritenderim" me Nr. të Prokurimit 623-23-7702-5-2-1/C514, Kërkesës dhe rekomandimit të Menaxherit të kontratës 3 Nr. Prot. 4022 të datës 10.12.2025, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për ndërrimin (kolaodimin) e pozicioneve në kontratën me titull "Ndërtimi dhe rregullimi i infrastrukturës në stacionin e autobusëve - Ritenderim"

1. Me këtë vendim **lejohe**t ndërrimi (kolaodimi) i pozicioneve të situacionit nga një pozicion në tjetrin, në kontratën me titull "Ndërtimi dhe rregullimi i infrastrukturës në stacionin e autobusëve - Ritenderim" me Nr. të Prokurimit 623-23-7702-5-2-1/C514.
2. Ndërrimi (kolaodimi) i pozicioneve sipas pikës 1 të këtij vendimi do të bëhet nga pozicioni i kontratës: Transporti deri te vendi i vendosjes dhe montimi i kabinës së tipit 1 me gjatësi 6.00 metra, gjerësi 1.75 metra dhe lartësi 2.50 metra dhe tipit 2 me gjatësi 9.00 metra, gjerësi 1.75 metra dhe lartësi 2.50 metra për pritje të autobusit, në pozicionin e domosdoshme për realizim: Transporti deri te vendi i vendosjes dhe montimi i kabinës së tipit 3 me gjatësi 4.80 metra, gjerësi 1.80 metra dhe lartësi 2.50 metra, pa implikime financiare shtesë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Zyra e Prokurimit, Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrësi i Drejtëpërdrejtë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Ofruesi i shërbimeve (punëkryesi) i kontratës me titull "Ndërtimi dhe rregullimi i infrastrukturës në stacionin e autobusëve - Ritenderim" me Nr. të Prokurimit 623-23-7702-5-2-1/C514, i ka rekomanduar menaxherit të kontratës ndërrimin (kolaodimin) e pozicioneve në këtë kontratë, me qëllim të përfundimit të punimeve të këtij projekti.

Pas kësaj, Menaxheri i Kontratës përmes kërkesës dhe rekomandimit 3 Nr. Prot. 4022 të datës 10.12.2025, ka kërkuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ ndërrimin (kolaodimin) e pozicioneve nga një pozicion në tjetrin, në kontratën me titull "Ndërtimi dhe rregullimi i infrastrukturës në stacionin e autobusëve - Ritenderim" me Nr. të Prokurimit 623-23-7702-5-2-1/C514 si në vijim: Transporti deri te vendi i vendosjes dhe montimi i kabinës së tipit 1 me gjatësi 6.00 metra, gjerësi 1.75 metra dhe lartësi



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), Thirrjes publike për aplikim nga Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm me Nr. Prot. 4002 të datës 8.12.2025, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve

1. **Caktohet** komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për shfrytëzimin e shtandeve mobile të drurit, sipas thirrjes publike për aplikim me nr. prot. 4002, të datës 8.12.2025, në këtë përbërje:
 - 1.1. Fidan Hoti, kryesues,
 - 1.2. Nazmi Bellaqa, anëtar – shoqëria civile,
 - 1.3. Agnesa Ramadani, anëtare,
 - 1.4. Arsim Kastrati, anëtar,
 - 1.5. Bekim Krasniqi, anëtar.
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për shfrytëzimin e shtandeve mobile të drurit, sipas thirrjes publike për aplikim me nr. prot. 4002, të datës 8.12.2025.
3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
4. Obligohet komisioni që, pas përfundimit të punëve, të hartojë raport me shkrim për kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.
5. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.
7. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 12, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e grupit punues për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve investive nr. 01. Nr. 109, të datës 14.7.2006, të Komunës së Rahovecit

1. **Caktohet** grupi punues për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve investive nr.01. Nr. 109, të datës 14.7.2006, në këtë përbërje:
 - 1.1. Jetmir Ukaj - zyrtar teknik i ndërtimtarisë, kryesues,
 - 1.2. Mirsad Shala - zyrtar ligjor, anëtar,
 - 1.3. Diellza Çanta - zyrtare e lartë për leje ndërtimore, anëtare,
 - 1.4. Biondina Ramaj - zyrtare e lartë për mbrojtje të mjedisit, anëtare,
 - 1.5. Sylejman Daka - inxhinier i ndërtimtarisë, anëtar,
 - 1.6. Hasan Eminazeri - inspektor i komunikacionit dhe i ndërtimtarisë, anëtar,
 - 1.7. Sokol Thaqi - shoqëria civile, anëtar.
2. Grupi punues ka për detyrë që të bëjë ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve investive nr.01. Nr. 109, të datës 14.7.2006.
3. Obligohet grupi punues që të veprojë duke u bazuar në ligjet dhe aktet nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
4. Grupi punues do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e grupit punues për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve investive nr. 01. Nr. 109, të datës 14.7.2006 dhe Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Rahovecit.
6. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me nr. prot. 02/6718, i datës 21.11.2025.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të grupit punues,
- Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 6780 Nr. i faq/Br.str/No.pg 180
Data/Datum/Date 15 / 12 / 25
RAHOVEC / ORAHOVAC

Duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenin 3, nenin 4 paragrafi 2 pika 2.2 të Udhëzimit Administrativ të (MAPL) Nr. 01/2018 për caktimin e stafit mbështetës në komuna, nenit 5 pika 1, nenit 7 dhe nenit 10 të Rregullores për Organizimin e Brendshëm, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës së Komunës së Rahovecit 01. Nr. 1092 datë 27.03.2015, nenit 74, nenit 81 paragrafi 1 pika 1.4, nenit 82 paragrafi 1 pika 1.2 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e Zyrtares për Marrëdhënie me Publikun në Kabinetin e Kryetarit të Komunës

1. Znj. Almedine Jaha nga Rahoveci, **EMËROHET** Zyrtare për Marrëdhënie me Publikun në Kabinetin e Kryetarit të Komunës së Rahovecit.
2. Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtares për Marrëdhënie me Publikun përcaktohen nga Kryetari i Komunës.
3. Ky emërim fillon nga data **15.12.2025** dhe përfundon me përfundimin e mandatit të Kryetarit të Komunës, nëse ky emërim nuk ndërpritet më herët.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- **Almedine Jaha,**
- **Drejtoria për Buxhet dhe Financa,**
- **NJMBNJ, dhe**
- **Arkivi.**





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PRESIDENTIA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6781 Nr. i faq./Br.str./No.pg 181

Data/Datum/Date 15 / 12 / 25

RAHOVEC / ORAHOVAC

Duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenin 3, nenin 4 paragrafi 2 pika 2.3 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2018 për caktimin e stafit mbështetës në komuna, nenit 5 pika 1, nenit 7 dhe nenit 10 të Rregullores për Organizimin e Brendshëm, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës së Komunës së Rahovecit 01. Nr. 1092 datë 27.03.2015, nenit 74, nenit 81 paragrafi 1 pika 1.4, nenit 82 paragrafi 1 pika 1.2 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahoveci, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e Zyrtarit Administrativ në Kabinetin e Kryetarit të Komunës

1. Z. Dervish Çadraku nga fshati Malësi e Vogël (Radoste), komuna e Rahovecit, **EMËROHET** Zyrtar Administrativ në Kabinetin e Kryetarit të Komunës së Rahovecit dhe këshilltar për kategoritë e dala nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe për çështjen kombëtare.
2. Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtarit Administrativ përcaktohen nga Kryetari i Komunës.
3. Ky emërim fillon nga data **15.12.2025** dhe përfundon me përfundimin e mandatit të Kryetarit të Komunës, nëse ky emërim nuk ndërpritet më herët.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Dervish Çadraku,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Zyra e Personelit, dhe
- Arkivi.

Smail Latifi
Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRILSDRIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6782 Nr. i faq./Br.str./No.pg 181

Data/Datum/Date 15 / 12 / 25

RAHOVEC / ORAHOVAC

Duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenin 4 paragrafi 2 pika 2.1 lidhur me nenin 8 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ të (MAPL) Nr. 01/2018 i datës 26.06.2018 për caktimin e stafit mbështetës në komuna, nenit 5 pika 1, nenit 7 dhe nenit 10 të Rregullores për Organizimin e Brendshëm, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës së Komunës së Rahovecit 01. Nr. 1092 datë 27.03.2015, nenit 74, nenit 81 paragrafi 1 pika 1.4, nenit 82 paragrafi 1 pika 1.2 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahoveci Nr. 1005 i datës 29.03.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e Shefit të Kabinetit në Zyrën e Kryetarit të Komunës

1. Z. Ardit Halilaj nga fshati Gur i Kuq (Petkoviq), komuna e Rahovecit, **EMËROHET** Shef i Kabinetit në Zyrën e Kryetarit të Komunës.
2. Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e Shefit të Kabinetit përcaktohen nga Kryetari i Komunës.
3. Ky emërim fillon nga data **15.12.2025** dhe përfundon me përfundimin e mandatit të Kryetarit të Komunës, nëse ky emërim nuk ndërpritet më herët.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- **Ardit Halilaj,**
- **Drejtoria për Buxhet dhe Financa,**
- **Zyra e Personelit, dhe**
- **Arkivi.**

Smajl Latifi
Kryetari i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine **Municipal Mayor**



KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PRESIEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6783 Nr. i faq/Br.str/No.pg 181

Data/Datum/Date 15 / 12 / 25

RAHOVEC / ORAHOVAC

Duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenin 3, nenin 4 paragrafi 2 pika 2.4 të Udhëzimit Administrativ të (MAPL) Nr. 01/2018 për caktimin e stafit mbështetës në komuna, nenit 5 pika 1, nenit 7 dhe nenit 10 të Rregullores për Organizimin e Brendshëm, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës së Komunës së Rahovecit 01. Nr. 1092 datë 27.03.2015, nenit 74, nenit 81 paragrafi 1 pika 1.4, nenit 82 paragrafi 1 pika 1.2 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e Zyrtarit për Logjistikë në Kabinetin e Kryetarit të Komunës

1. Z. Ruzhdi Krasniqi nga fshati Ratkoc, komuna e Rahovecit, **EMËROHET** Zyrtar për Logjistikë në Kabinetin e Kryetarit të Komunës së Rahovecit.
2. Të drejtat detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtarit për Logjistikë përcaktohen nga Kryetari i Komunës.
3. Ky emërim fillon nga data **15.12.2025** dhe përfundon me përfundimin e mandatit të Kryetarit të Komunës, nëse ky emërim nuk ndërpritet më herët.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Ruzhdi Krasniqi,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- NJMBNJ, dhe
- Arkivi.


Smajl Latifi
Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT I KOMUNES/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6791 Nr. i faq./Br.str./No.pg 182

Data/Datum/Date 18 / 12 / 25

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, nenit 72 të Rregullores Nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, rekomandimit të Menaxherit të Projektit 4 Nr. Prot. 1001 të datës 17.12.2025 për ndërprerjen e kontratës me titull: "Furnizimi me pelet për nevojat e Komunës së Rahovecit për vitin 2025/2026" me nr. të prokurimit 623-25-3824-1-2-1/C683, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanëshme me titull "Furnizimi me pelet për nevojat e Komunës së Rahovecit për vitin 2025/2026"

1. **Miratohet** kërkesa e menaxherit të projektit dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanëshme me titull "Furnizimi me pelet për nevojat e Komunës së Rahovecit për vitin 2025/2026" me nr. të prokurimit 623-25-3824-1-2-1/C683.
2. Ndërprerja e kontratës me marrëveshje të dyanëshme sipas pikës 1 të këtij vendimi bëhet për shkak të mospërbushjes së obligimeve të kontratës, respektivisht mos furnizimin me artikujt e përshkruar në kontratë.
3. Obligohet Zyra e Prokurimit që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme konform dispozitave ligjore në fuqi për ndërprerjen e kontratës sipas pikës 1 të këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Pas zhvillimit të të gjitha procedurave të prokurimit, Komuna e Rahovecit (në vazhdim Autoriteti Kontraktues), ka nënshkruar Kontratë publike kornizë me Operatorin Ekonomik N.P.T. "Haris" me seli në rr. UÇK-së në Rahovec (në vazhdim Kontraktuesi), me titull "Furnizimi me pelet për nevojat e Komunës së Rahovecit për vitin 2025/2026" me nr. të prokurimit 623-25-3824-1-2-1/C683 me Nr. Prot. 2303 të datës 08.07.2025.

Pas nënshkrimit të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka kryer punët sipas kushteve të parapara në kontratë.

Mirpo, pas nënshkrimit të kontratës, çmimi i peletit që është objekt i kësaj kontrate është dyfishuar në tregun global, e poashtu edhe në tregun e Republikës së Kosovës.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI PËR Kryetarin / KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 6794 Nr. i faq./Br.str./No.pg 182
Data/Datum/Date 19 / 12 / 25
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), Rregullores për dhënien e titujve të nderit, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Rahovecit me nr. prot. 01 Nr. 327/22 e datës 31.05.2022, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve

1. **Caktohet** komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve (propozimeve) për përzgjedhjen e laureatëve të sportit për vitin 2025 në komunën e Rahovecit, në këtë përbërje:
 - 1.1. Taulant Haxhimustafa, kryesues,
 - 1.2. Vlora Sylaj – Reshiti, anëtare,
 - 1.3. Nadir Sylejmani, anëtar,
 - 1.4. Muharem Morina, anëtar,
 - 1.5. Servete Kastrati, anëtare,
 - 1.6. Shaip Shala, anëtar
 - 1.7. Arbnora Sokoli, anëtare.
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve (propozimeve) për përzgjedhjen e laureatëve të sportit për vitin 2025 në komunën e Rahovecit.
3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në njoftimin e shpallur nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport të datës 10.12.2025.
4. Obligohet komisioni që, pas përfundimit të punëve, të hartojë raport me shkrim për kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport.
5. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë deri më 24.12.2025.
6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6795 Nr. i faq/Br.str/No.pg 182

Data/Datum/Date 10 / 12 / 25

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 71 paragrafi 1 lidhur me nenin 86 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyratë Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-294, nenit 41 paragrafi 2 i Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 90/2010"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.3.2017, kërkesës së Alban Bajraktari nga fsh. Polluzhë 3 nr. prot. 3971 të datës 05.12.2025, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për përfundimin e pezullimit të marrëdhënies së punës

1. **Miratohet** si e bazuar kërkesa e Alban Bajraktarit nga fshati Polluzhë, me nr. prot. 3971, e datës 5.12.2025, për përfundimin e pezullimit të marrëdhënies së punës.
2. I lartpërmenduri kthehet në pozitën e njëjtë të marrëdhënies së punës: Mësimdhënës i gjuhës angleze në ShFMU "Rudolf Walther" në Dejnë, nga data 1.1.2026.
3. Obligohet zyrtari/ja për paga në Drejtorinë për Arsim dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa, ta fusin në listën e pagave të lartpërmendur sipas pikës 1 të këtij vendimi
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Arsim dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi 04 nr. prot. 1700, i datës 30.4.2024.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Alban Bajraktari nga fshati Polluzhë, i sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Mësimdhënës i gjuhës angleze në ShFMU "Rudolf Walther" në Dejnë, ka parashtruar kërkesë me nr. prot. 1212, të datës 4.4.2024, për pezullimin e marrëdhënies së punës, për shkak të angazhimit të tij si anëtar i Kuvendit të Komunës së Rahovecit.

Pas përfundimit të këtij mandati, i lartpërmenduri ka parashtruar kërkesë për përfundimin e pezullimit të marrëdhënies së punës dhe njëkohësisht kthimin e tij në vendin e mëparshëm të punës si mësimdhënës i gjuhës angleze në ShFMU "Rudolf Walther" në Dejnë.

Andaj, pas shqyrtimit të të gjitha provave, duke u bazuar në nenin 41 paragrafi 2 i Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 dhe nenin 71 paragrafi 1 lidhur me nenin 86 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyratë Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-294, Alban Bajraktarit nga fshati Polluzhë, i përfundon



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



	REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PRESIEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET		
Njësia Nr./Br./No <u>02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)</u>		
Nr./Br./No <u>6796</u> Nr. i faq./Br.str./No.pg <u>182</u>		
Data/Datum/Date <u>19 / 12 / 25</u>		
RAHOVEC / ORAHOVAC		

Komisioni Komunal për Riintegrim, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Sipas Rregullores së QRK-së, nr. 22/2020, për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, neni 44, paragrafi 1, nënparagrafi 4.1 dhe paragrafi 5, neni 21, paragrafi 3 dhe neni 33, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, 1.10 si dhe paragrafi 4 dhe 6 si në dispozitiv të Rregullores së QRK-së, nr. 22/2020, për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, mbështetur në vendimin e kryetarit të Komunës së Rahovecit, Nr. 271, të datës 14.7.2014, për themelimin e Komisionit Komunal për Riintegrim, në harmoni me Ligjin Nr. 05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET kërkesa e zn. [REDAKTUAR] me nr. të letërnjoftimit **1007861342**, e riatdhesuar nga **Gjermania** me familjen **3-anëtarëshe**, e kthyer në Republikën e Kosovës më **12.12.2019**, për vazhdimin e mbështetjes nga Masat Emergjente të Riintegrit, për **akomodim (qira)** në kohëzgjatje prej **gjashtë (6) muajsh**, për periudhën nga data **1.11.2025 deri më 30.4.2026**, në vlerën prej **280 (dyqind e tetëdhjetë) euro** për çdo muaj, duke përfshirë edhe shpenzimet komunale. Miratimi bëhet në bazë të **anamnezës sociale të Qendrës për Punë Sociale (QPS) në Prishtinë**, me nr. reference **1360**, të dates **17.12.2025**.

2. Përfitues nga pika 1 e këtij vendimi është familja (3) - anëtarëshe nga komuna e Rahovecit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Ministria e Punëve të Brendshme.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Komisioni Komunal për Riintegrim i Komunës së Rahovecit, në seancën e mbajtur më 19.12.2025, ka rishqyrtuar kërkesën e bazuar në vlerësimin e situatës sociale dhe anamnezën sociale të Qendrës për Punë Sociale (QPS) në Prishtinë, me nr. reference 1360, lidhur me të riatdhesuarën znj. [REDAKTUAR] nga komuna e Rahovecit, e cila aktualisht jeton në Prishtinë, për vazhdimin e mbështetjes nga Masat Emergjente të Riintegrit për akomodim me qira. Nga dokumentacioni i paraqitur, u konstatua se zn. [REDAKTUAR] është pjesë e një familjeje 3-anëtarëshe në gjendje të rëndë sociale dhe ekonomike, me fëmijë që përballen me probleme shëndetësore, si dhe me histori të ekspozimit ndaj dhunës në familje. Në këtë kontekst, QPS-ja ka rekomanduar vazhdimin e akomodimit edhe për një periudhë shtesë prej gjashtë (6) muajsh. Komisioni, duke u bazuar në dispozitat përkatëse të Rregullores QRK nr. 22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, pas shqyrtimit të plotë të të gjitha dëshmive dhe rrethanave faktike, ka vlerësuar që janë plotësuar kushtet ligjore për vazhdimin e mbështetjes nga Masat Emergjente të Riintegrit për akomodim me qira edhe për një periudhë prej gjashtë (6) muajsh, andaj u vendos si në dispozitiv.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KOMUNA E RAHOVCIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI / KRYETARIT

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6797 Nr. i faq./Br.str./No.pg 182

Data/Datumi/Date 22 / 12 / 25

R. RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, kërkesës së QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e dëmeve materiale dhe financiare në Qendrën e Mjekësisë Familjare (QMF) në Ratkoc

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e dëmeve materiale dhe financiare të shkaktuara nga persona të përgjegjshëm në Qendrën e Mjekësisë Familjare (QMF) në Ratkoc, në këtë përbërje:
 - 1.1. Sylejman Daka, kryesues,
 - 1.2. Avdi Kastrati, anëtar,
 - 1.3. Ardian Rama, anëtar,
 - 1.4. Ahmet Latifi, anëtar,
 - 1.5. Samir Hasku, anëtar.
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë vlerësimin e dëmeve materiale dhe financiare të shkaktuara nga persona të përgjegjshëm në Qendrën e Mjekësisë Familjare (QMF) në Ratkoc.
3. Obligohet komisioni që, pas përfundimit të punës, të hartojë raport me shkrim për kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Komunën e Rahovecit.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë më datë 26.12.2025.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Anëtarët e komisionit,
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Nr./Br./No. 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No. 6798 Nr. i faq./Br./str./No. pg. 182

Data/Datum/Date 22 / 12 / 25

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), Rregullores për dhënie të titujve të nderit, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Rahovecit me nr. prot. 01 Nr. 327/22 e datës 31.05.2022, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve

1. **Caktohet** komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve (propozimeve) për përzgjedhjen e laureatëve të sportit për vitin 2025 në komunën e Rahovecit, në këtë përbërje:
 - 1.1. Nadir Sulejmani, kryesues,
 - 1.2. Vlora Reshiti, anëtare,
 - 1.3. Qemajl Krasniqi, anëtar,
 - 1.4. Senad Alirifa, anëtar
 - 1.5. Arbnora Sokoli, anëtare,
 - 1.6. Servete Kastrati, anëtare,
 - 1.7. Shaip Shala, anëtar.
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve (propozimeve) për përzgjedhjen e laureatëve të sportit për vitin 2025 në komunën e Rahovecit.
3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në njoftimin e shpallur nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport të datës 10.12.2025.
4. Obligohet komisioni që, pas përfundimit të punëve, të hartojë raport me shkrim për kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport.
5. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë deri më 24.12.2025.
6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe
- Arkivit.

Smail Latifi
Kryetari i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 6806 Nr. i faq/Br.str/No.pg 183
Data/Datum/Date 23 / 12 / 25
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), Rregullores për dhënien e titujve të nderit, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Rahovecit me nr. prot. 01 Nr. 327/22 e datës 31.05.2022, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve

1. **Caktohet** komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve (propozimeve) për përzgjedhjen e laureatëve të kulturës dhe të rinisë për vitin 2025 në komunën e Rahovecit, në këtë përbërje:
 - 1.1. Muharem Morina, kryesues,
 - 1.2. Naim Kafexhiu, anëtar,
 - 1.3. Naser Dula, anëtar.
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve (propozimeve) për përzgjedhjen e laureatëve të kulturës dhe të rinisë për vitin 2025 në komunën e Rahovecit.
3. Obligohet komisioni që, pas përfundimit të punëve, të hartojë raport me shkrim për kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë deri më datë 26.12.2025.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës
RAHOVEC
ORAHOVAC
OPŠTINA RAHOVEC / MUNICIPALITY RAHOVEC



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: “Furnizimi me pelet për nevojat e komunës së Rahovecit”, me nr. prokurimi: 623-25-11437-1-2-5 dhe me nr. të brendshëm 623-25-049-1-2-5; të datës 29.12.2025, në këtë përbërje:
 - 1.1. Egzon Thaqi, kryesues,
 - 1.2. Enise Dina, anëtare,
 - 1.3. Jeton Krasniqi, anëtar.
2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin “Furnizimi me pelet për nevojat e komunës së Rahovecit”, me nr. prokurimi: 623-25-11437-1-2-5 dhe me nr. të brendshëm: 623-25-049-1-2-5, të datës 29.12.2025.
3. Obligohet komisioni që këto punë t’i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Zyrës së Prokurimit, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

Kabineti i Kryetarit

Nr. 6818 / r. i fag / Br. str. / No. 184
30.12.2025

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.4 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e [redacted] nga Rahoveci me Nr. Protokolit 06-553/01-0047030/25, e dt. 24.12.2025 për ndihmë financiare prej 500.00€ (pesëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Znj. [redacted] nga Rahoveci me datë 24.12.2025 ka parashtruar kërkesë për ndihmë financiare për lehonë (lindje) pasi që me datë 18.12.2025 ka lindur **Djal** në QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec.

Marrë parasysh se, e lartpërmendura nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe me këtë rast e njëjta pas shpenzimeve të lindjes e ka të vështirë përballimin e shpenzimeve të blerjes së gjërave elementare për fëmijën, është e domosdoshme ndihma financiare për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë për znj. [redacted] si dhe ndihma për sigurimin e gjërave elementare për foshnjën.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Me vendim të njoftohen:

- Znj. [redacted], nga Rahoveci,
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.4 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa [redacted] nga Rahoveci me Nr. Protokolit 06-553/01-0047401/25, e dt. 26.12.2025 për ndihmë financiare prej 500.00€ (pesëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Znj. [redacted] nga Rahoveci me datë 26.12.2025 ka parashtruar kërkesë për ndihmë financiare për lehonitë (lindje) pasi që me datë 20.12.2025 ka lindur **Vajz** në QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec.

Marrë parasysh se, e lartpërmendura nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe me këtë rast e njëjta pas shpenzimeve të lindjes e ka të vështirë përballimin e shpenzimeve të blerjes së gjërave elementare për fëmijën, është e domosdoshme ndihma financiare për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë për znj. [redacted] si dhe ndihma për sigurimin e gjërave elementare për foshnjën.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Me vendim të njoftohen:

- Znj. [redacted] nga Rahoveci,
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KOMUNA E RAHOVECIT / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6820 Nr. i faq./Br.str./No.pg 184

Data/Datum/Date 30 / 12 / 2025

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe propozimit të Përgjegjësit të Njesisë Kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: “Pastrimi dhe mirëmbajtja higjienike e objekteve të Komunës – lot 2 - Pastrimi dhe mirëmbajtja higjienike e objekteve shëndetësore”, me numër të kontratës: 623-25-6580-2-1-1/C701, si në vijim:
 - 1.1. Elbunit Kryeziu, drejtori i QKMF “Dr. Fahredin Hoti” në Rahovec, **CAKTOHET** menaxher i kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2. Isak Hoti, drejtor i Drejtorisë për Administratë (sipas autorizimit), **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhimin të Kontratës, si dhe të rregullave të tjera, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe të emërimit të Menaxherit të kontratës (MK), të gjitha përgjegjësitë, përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë Kontratën, barten nga zyra e prokurimit të Menaxheri i Kontratës.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KOMUNA E RAHOVECIT / REPUBLIKA KOSOVË / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNALNA OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR'S CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6824 Nr. i faq./Br.str./No.pg 185

Data/Datum/Date 30 / 12 / 2025

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe propozimit të Përgjegjësit të Njesisë Kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: “Pastrimi dhe mirëmbajtja higjienike e objekteve të Komunës – lot 1 - Pastrimi dhe mirëmbajtja higjienike e objekteve të Komunës”, me numër të kontratës: 623-25-6580-2-1-1/C700, si në vijim:
 - 1.1. Bekim Krasniqi i sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Zyrtar për arkiv në Drejtorinë për Administratë, **CAKTOHET** menaxher i kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2. Isak Hoti, drejtor i Drejtorisë për Administratë (sipas autorizimit), **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualin për Përdorim të Modulit për Menaxhimin të Kontratës, si dhe të rregullave të tjera, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe të emërimit të Menaxherit të kontratës (MK), të gjitha përgjegjësitë, përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë Kontratën, barten nga zyra e prokurimit të Menaxherit të Kontratës.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINETI PRESEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 6824 Nr. i faq./Br.str./No.pg 185
Data/Datum/Date 31/12/25
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 68 paragrafi 1 pika 1.1, nenit 69 paragrafi 1 pika 1.2, lidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrat e Publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 21/2023"), nenit 13 paragrafi 3 pika 2.1 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrat e Publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 2/2025"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për pezullimin e marrëdhënies së punës

1. **Z. Qazim Cana**, i sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Koordinator në QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec, i pezullohet marrëdhënia e punës, pa pagesë, nga data 01.01.2026 deri në përfundim të mandatit të rregullt të Kuvendit të Komunës së Rahovecit, nëse ky pezullim nuk ndërpritet më herët.
2. Ky pezullim bëhet për arsye se i lartpërmenduri është zgjedhur anëtar i Kuvendit të Komunës në Rahovec në zgjedhjet lokale të vitit 2025, pozitë të cilën do ta mbajë.
3. I lartpërmenduri e ruan të drejtën e kthimit në pozitën e mëparshme pas përfundimit të mandatit të anëtarit të Kuvendit të Komunës ose edhe më herët me kërkesën e tij.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Njësia e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Z. Qazim Cana, i sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Koordinator në QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec është zgjedhur anëtar i Kuvendit të Komunës në Rahovec në zgjedhjet lokale të vitit 2025, i cili njëkohësisht ka bërë betimin si anëtar i Kuvendit të Komunës me datë 08.12.2025.

Andaj, Kryetari i Komunës në cilësinë e Zyrarit Kryesor Administrativ, në zbatim të nenit 68 paragrafi 1 pika 1.1, nenit 69 paragrafi 1 pika 1.2, lidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrat e Publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 21/2023") dhe nenit 13 paragrafi 3 pika 2.1 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrat e Publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 2/2025") e pezullon nga marrëdhënia e punës pa pagesë z. Qazim Cana nga data 01.01.2026 deri në përfundim të mandatit të rregullt të Kuvendit të Komunës së Rahovecit, nëse ky pezullim nuk ndërpritet më herët, për shkak se i njëjti është zgjedhur anëtar i Kuvendit të Komunës në Rahovec në zgjedhjet lokale të vitit 2025, pozitë të cilën do ta mbajë.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6825 Nr. i faq./Br.str./No pg. 185

Data/Datum/Date 31/12/25

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 68 paragrafi 1 pika 1.1, nenit 69 paragrafi 1 pika 1.2, lidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 21/2023"), nenit 13 paragrafi 3 pika 2.1 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 2/2025"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për pezullimin e marrëdhënies së punës

1. **Znj. Melinda Oruqi Iska**, e sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Infermiere në QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec, i pezullohet marrëdhënia e punës, pa pagesë, nga data 01.01.2026 deri në përfundim të mandatit të rregullt të Kuvendit të Komunës së Rahovecit, nëse ky pezullim nuk ndërpritet më herët.
2. Ky pezullim bëhet për arsye se e lartpërmendura është zgjedhur anëtare e Kuvendit të Komunës në Rahovec në zgjedhjet lokale të vitit 2025, pozitë të cilën do ta mbajë.
3. E lartpërmendura e ruan të drejtën e kthimit në pozitën e mëparshme pas përfundimit të mandatit të anëtares së Kuvendit të Komunës ose edhe më herët me kërkesën e saj.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Njësia e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Znj. Melinda Oruqi Iska, e sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Infermiere në QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec është zgjedhur anëtare e Kuvendit të Komunës në Rahovec në zgjedhjet lokale të vitit 2025, e cila njëkohësisht ka bërë betimin si anëtare e Kuvendit të Komunës me datë 08.12.2025.

Andaj, Kryetari i Komunës në cilësinë e Zyrtarit Kryesor Administrativ, në zbatim të nenit 68 paragrafi 1 pika 1.1, nenit 69 paragrafi 1 pika 1.2, lidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 21/2023") dhe nenit 13 paragrafi 3 pika 2.1 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 2/2025") e pezullon nga marrëdhënia e punës pa pagesë znj. Melinda Oruqi Iska nga data 01.01.2026 deri në përfundim të mandatit të rregullt të Kuvendit të Komunës së Rahovecit, nëse ky pezullim nuk ndërpritet më herët, për shkak se e njëjta është zgjedhur